

UDHËZIM
Nr. 5, datë 1.8.2012

**PËR NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME, NË INSTITUCIONET PUBLIKE
REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 10, datë 1.10.2012)

(i përditësuar)

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror është:

- | | |
|---|-----------|
| a) Për fëmijët e vendosur në shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç | 300 lekë; |
| b) Për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 3-6 vjeç | 310 lekë; |
| c) Për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 6-15 vjeç | 330 lekë; |
| d) Për personat e vendosur në qendrat e zhvillimit | 340 lekë; |
| e) Për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve | 300 lekë; |
| f) Për klientët në qendrat pritëse, rehabilituese dhe riintegruese për viktimat e trafikimit dhe të dhunës sipas kategorive të përfituesve të përcaktuar në gërmat "a", "b", "c", "d" dhe "e" të këtij udhëzimi. <i>Për klientët e grup-moshës 16 vjeç deri në moshën e daljes në pension, sipas kategorisë së përfituesve të përcaktuar në gërmën "e" të këtij udhëzimi.</i> | |

2. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në qendra ditore publike të përkujdesit shoqëror është:

- | | |
|------------------------------------|-----------|
| a) Në qendrat ditore polivalente | 160 lekë; |
| b) Në qendrat ditore të zhvillimit | 220 lekë; |
| c) Në shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç | 220 lekë; |
| d) Në shtëpinë e fëmijës 3-15 vjeç | 220 lekë; |
| e) në shtëpinë e të moshuarve | 160 lekë. |

3. Niveli i kuotës financiare për shpenzimet ditore ushqimore për kuzhinierët dhe ndihmëskuzhinierët, që punojnë në këto institucione, është i barabartë me 60% të kuotës financiare ditore për ushqim, për kategoritë e përfituesve të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

4. Efektet financiare nga rritja e nivelit të kuotës financiare të shpenzimeve për ushqim, përballohen nga fondet e buxhetit qendror, të programuara për shërbimet e përkujdesit shoqëror për vitin 2013.

5. Udhëzimi nr. 1547, datë 11.12.2009 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe e shtrin efektin financiar nga 1.1.2013.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera